



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2022:130291

Datë: 08.12.2022

Numri i dokumentit: 03727173

P. nr.100/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Njazi Morina, me zyrtaren ligjore Albane Morina, në lëndën penale kundër të akuzuarit E. M. nga fshati Ll., Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par. 1 lidhur me par. 6 të KPRK-së, e sipas aktakuzës PP/II.nr.884/2022 të dt. 23.06.2022, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më 19.09.2022, në prezencën e prokurorit të shtetit Sadri Alija, të akuzuarit E. M., **më 22 shtator 2022, nxjerri dhe publikisht shpalli këtë:**

A K T G J Y K I M

E. M., nga i ati A. e ëma R., e gjinisë G., i lindur më ..., në fshatin Ll., Komuna e Malishevës, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, i ati i 3 fëmijëve, ka te kryer shkollën fillore, punon si mjeshtër i fasadës, i pa dënuar me pare, i gjendjes së dobët ekonomike, më numër personal

ËSHTË FAJTOR

Sepse,

Nga data e pavërtetuar e gjerë më datën 08.06.2020, në shtëpinë e tij në fshatin D., Komuna e M., me qëllim që vetës t'i sjell përfitim pasuror, në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me dispozitën nenit 61 të Ligjit për energjinë elektrike të Republikës së Kosovës, nr.05/L-85, ka shfrytëzuar rrymën elektrike në atë mënyrë që gjatë kontrolleve nga ana e zyrtarëve të K.-it, në datën e lartcekur është konstatuar se i pandehuri, në njehsorin elektrik me numër ..., ka qenë i ç' kyçur, mirëpo është lidhur direkt në tensionin pa njehsor matës duke anashkaluar kështu regjistrimin e saktë të energjisë së shpenzuar elektrike, me ç' rast ndërmarrjes së dëmtuar K. - divizioni në Gj. i ka shkaktuar dëm në shumën e përgjithshme prej 379.21 euro.

- me çka ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 lidhur me par. 6 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 3,4,7,17,38,39,46,47,48,49,69,70,314 par.1 lidhur me par.6 të KPRK-së, dhe neneve 248 dhe 365 të KPPK-së, të akuzuarit i shqipton:

DËNIMIN ME KUSHT

Ashtu që të akuzuarin **E. M.** e dënon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej tetëdhjete (80) ditësh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën kohore prej një (1) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Detyrohen i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shpenzimet në shumën prej 30,00 €, për shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 30,00 €, në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara K. - Distrikti në Gj., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Arsyetime

Prokuroria Themelore në Gjakovë, në këtë gjykate ka paraqitur aktakuzë PP/II.nr.884/2022 të datës 23.06.2022, kundër të akuzuarit E. M. nga fshati Ll., Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par. 1 lidhur me par. 6 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar më dt. 19.09.2022, dhe pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, të pandehurit iu dha mundësia për ta pranuar fajësinë apo të deklarohet i pafajshëm.

Pas deklarimit të pandehurit se ndjehet fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet nga Prokuroria, gjykata me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri pasi që është bindur plotësisht se ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë.

Prokurori i shtetit deklaron se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë dhe se pranimi i fajësisë mbështetet në provat që gjenden në shkresat e lëndës, dhe meqenëse i akuzuari e pranoi fajësinë, me rastin e shqiptimit të dënimit gjykata ti ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, dhe i akuzuari të shpallët fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I pandehuri E. M., deklarohet i fajshëm për veprën penale për të cilën ngarkohet, duke shtuar se më vjen keq për rastin i cili ka ndodhur, i premtoj gjykatës se nuk do të përsëris vepër tjetër penale, jam i gjendjes së varfër ekonomike.

Po ashtu nga shkresat e lëndës dhe nga provat materiale siç janë: K., procesverbal nr. ... i dt.08.06.2020; foto dokumentacioni; K. procesverbal me nr..... i dt. 26.07.2021; fotografia e shtëpisë të akuzuarit; K. proces për pranimin instalimit elektrik me shifër ... i dt.24.07.2021; kalkulimi i RH me shifër DGJ ... ID e rastit ..., dt.29.07.2021; K.|CO faturë D. dt.30.07.2021; kalkulimi i RH me shifër DGJ ..., ID e rastit ...; K.|CO faturë D.dt.29.07.2021, si dhe shkresat tjera që gjenden në lëndë.

Gjykata me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore që pranimi i fajësisë të aprovohet nga ana e gjykatës. Gjykata ka pranuar deklarimin e pranimit të fajësisë nga i pandehuri dhe vlerëson se ky pranim i fajësisë

është i mbështetur edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto vërtetojnë në mënyrë bindëse për gjykatën elementet inkriminuese të veprës penale e ku krijohet edhe figura në tërësi e veprës penale që ka kryer i pandehuri, andaj mbi këtë bazë edhe gjykata i ka vlerësuar këto prova dhe deklarin e pranimit të fajësisë nga i pandehuri e ka pranuar si të tillë.

Me rastin e matjes së dënimit, Gjykata i ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit si rrethanë lehtësuese, Gjykata ka marrë parasysh pranimin e vullnetshëm të fajësisë, ndjen keqardhje për rastin që ka ndodhur, është hera e parë që ka kryer vepër penale, i ka premtuar gjykatës se nuk do të përsërit vepër tjetër penale, është i gjendjes së dobët ekonomike, të gjitha këto rrethana ndikuan që Gjykata ti zbatoi dispozitat e zbutjes së dënimit të parapara me nenin 69, 70 të KPRK-së. Gjykata si rrethanë rënduese për të akuzuarin mori faktin se ka kryer këtë vepër për të cilën akuzohet. Gjykata të akuzuarit i shqiptoi dënim me burgim në kohëzgjatje prej tetëdhjetë (80) ditësh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej një (1) viti nuk do të kryejë vepër tjetër penale, me bindje se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë bazuar në nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.1, 2.6 të KPP-së, si dhe bazuar në nenin 39 par.3 nën par. 3.2 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit nr. 05/L-036.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizim e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të nenit 365 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL
P.nr.100/2022, datë 22 shtator 2022

Zyrtarja ligjore,
Albane MORINA

Gjyqtari i vetëm gjykuar,
Njazi MORINA

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.